

komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Aliu punonte në fabrikën *Ereniku*. UÇK-së në fshatin e tij u bashkua më 20.05.1998. Ai dhe familja u detyruan të braktisnin shtëpinë më **3.09.1998**, kur forcat serbe e vendosën rrethimin e fshatit. Iu bashkëngjitën fshatarëve që u mbloodhën në një fushë të fshatit [**Kodrali/Kodralija**]. Duke i parë forcat serbe t'i afroheshin turmës, diku nga ora 09:00, Aliu u nda nga familja dhe u largua në drejtim të panjohur. Të nesërmen, i vëllai Dervishi e kishte zbuluar trupin e Aliut në vendin e quajtur *Livadhet e Rashkocit/Raşkovačke livade*. Po atë natë dhe me ndihmën e bashkëfshatarëve, Dervishi dhe Ismeti, vëllai i tretë i Aliut, e kanë varrosur atë në oborrin e shtëpisë familjare. Pas përfundimit të luftës, më 29.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Aliut në varrezat lokale.

**Burimet:** deklarata F.K, FDH-32441; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Fehmi (Imer) Berisha

(22.12.1970, shqiptar nga Rogova/Rogovo, komuna e Gjakovës/Đakovica, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fehmiu aderoi në radhët e UÇK-së më 26.04.1998, së bashku me vëllain Nesretin dhe disa të afërm. Ka marr pjesë në luftimet me forcat serbe përreth Rahovecit/Orahovac, që u zhvilluan gjatë muajit korrik të vitit 1998. Në datën **3.09.1998**, duke u kthyer nga Shqipëria, e plagosën në **Rogovë/Rogovo**. Bashkëluftëtarët e kanë bartur në spitalin e UÇK-së në Krushën e Madhe/Velika Kruša [Rahovec/Orahovac], ku ai ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse më 6.09.1998. E kanë varrosur në varrezat e fshatit të lindjes së Rogovës/Rogovo.

**Burimi:** SHFĐUÇK, *Feniksët...11*, 121-123.

## Smajl (Sadri) Ahmeti

(10.10.1925, shqiptar nga Kralani/Kraljane, komuna e Gjakovës/Đakovica, oficer i pensionuar, tre fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar **Kralanin/**

**Kraljane** më **4.09.1998**. Fshatarët filluan të largoheshin nga fshati. Smajli ka mbetur në shtëpi, ndërkaq djemtë Sadriu dhe Shabani me nënën Kajen dhe familjet e veta e braktisën fshatin. Ditën tjetër, Shabani u kthye në fshat dhe afro 200 metra larg nga shtëpia e ka gjetur trupin e palëvizshëm dhe pajetë të të atit. Konstatoi se Smajlin e kishin qëlluar me dy plumba në kokë dhe tre në trup. Po atë ditë, Shabani e ka varrosur të atin në të njëjtin vend ku e kishte gjetur. Atje, Smajli prehet edhe sot.

**Burimi:** deklarata S.A, FDH-16423.

## Safet (Demlush) Kuçi

(2.01.1951, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, ekonomist, katër fëmijë)

Safeti me familje jetonin në Gjakovë/Đakovica, në Rrugën *14 Qershori*. Në datën 6.09.1998, u nis për në Glllogjan/Glodane për një vizitë te baxhanaku Sahedin Shehu [të shikohet regjistrimi në faqen 170]. Sipas dëshmimeve të familjarëve, rrugës e sipër, ai duhej të ndalej te pronari i pikës së karburanteve, i quajtur Hili, në **Bistrashin/Bistražin**. Atë mbrëmje, nga ora 22:00, Safeti e kishte marr me telefon bashkëshorten Vahdeten, por linja u këput shumë shpejt. Tri ditë më vonë, Vahdetja kishte mësuar nga Hili se Safeti ka qenë tek ai më **6.09.1998**, dhe se i ka kërkuar para me hua, të cilat ky nuk i kishte dhënë. Safeti ka vazhduar rrugën për në Glllogjan/Glodane. Sipas rekomandimit të të vëllait, i cili ishte anëtar i UÇK-së, Vahdetja e ka paraqitur rastin në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë/Priština. Pas përfundimit të luftës, Vahdeten e thirrën në komunën e Gjakovës/Đakovica dhe i kumtuan se trupi i bashkëshortit të saj ishte identifikuar në mesin e mbetjeve mortore, të cilat ishin zhvarrosur nga varrezat e fshatit Piskotë/Piskot në muajin shtator të vitit 1999. Familjarët i varrosën mbetjet mortore të Safetit në varrezat e *Mëhallës Çabrat/Čabrat*. Në aktakuzën kundër Ramush Haradinajt, në mesin e viktimitave përmendet edhe emri i Safet Kuçi.

**Burimet:** deklarata V.K, FDH-30764; ICTY, IT-